

Iniciativat për Edukim Medial dhe Informativ

Ky dokument prezanton përpjekjet e Misionit të OSBE-së në Kosovë për iniciativat e edukimit medial dhe informativ (EMI).

Aktivitetet e paraqitura tregojnë se si iniciativat kreative të EMI kontribuojnë në sigurinë e përgjithshme përmes ndërtimit të një gjenerate të re të mendimtarëve kritikë.

Aktivitetet gjatë periudhës 2016- 2022

400 tekste shkollore

400 kopje të teksteve të edukimit medial u janë shpërndarë mësuesve dhe nxënësve në gjuhën shqipe.

3 shkolla

Tre shkolla fillore dhe të mesme e kanë përfshirë EMI si lëndë zgjedhore.

450 nxënës



Misioni i OSBE-së realizon ligjërata mbi edukimin medial, mediat digjitale dhe informim për mëse 450 nxënës të shkollave të mesme në 22 shkolla të ndryshme.

15 studentë

Pesëmbëdhjetë përfaqësues të studentëve të Universitetit në gjuhën serbe në Mitrovicën e Veriut marrin pjesë në kursin treditör të të menduarit kritik, komunikimit publik dhe edukimit medial.

70 mësimdhënës

70 mësimdhënës të shkollave të mesme janë trajnuar për konceptet e edukimit mediatik.

300 tekste shkollore

300 kopje të teksteve mbi edukimin medial u janë shpërndarë mësuesve dhe nxënësve në gjuhën serbe, turke dhe rome.

3 universitete

Tre universitete publike e kanë përfshirë EMI si lëndë obligative nga viti 2023/2024 e tutje.

2 programe televizive



Një medium në gjuhën serbe prodhon dy programe televizive 20-minutëshe në tema të hulumtuara nga studentët e Universitetit në gjuhën serbe në Mitrovicën e Veriut, të cilët kanë marrë pjesë në trajnimin e avancuar për edukim në mediat digjitale.

44 programe televizive

Katër sezona të programeve televizive, me 26 seriale mbi edukimin për mediat digjitale me titull EduMedia, duke kombinuar debatet në studio dhe intervistat në terren për të analizuar angazhimin me të gjitha format e mediave. Një emision i ngjashëm televiziv i quajtur "leximi mes rreshtave" është prodhuar në gjuhën serbe.

400 studentë

400 studentë për semestër mësojnë në Departamentin e Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës me silabusin e EMI të zhvilluar nga Misioni i OSBE-së që nga viti 2019.

1000 studentë



1000 studentë të diplomuar dhe universitar kanë marrë pjesë në seminarët për EMI të mbështetura nga Misioni mes viteve 2020-22.

3 video të animuara



Tre video të animuara për luftimin e lajmeve dhe informatave të rreme në lidhje me COVID-19.

10 video të animuara

Dhjetë video të animuara në gjuhët shqipe dhe serbe që trajtojnë rolin e Komisionit të Pavarur të Mediave dhe ofrojnë informata në lidhje me mekanizmat e ankesave në dispozicion të publikut për të denoncuar raportimin e paligjshëm, dezinformimin dhe lajmet e rreme në mediat audio-vizuale dhe online.

Aktivitetet e planifikuara për vitin 2023

► Trajnim i **20 gazetarëve** për të zbuluar dhe analizuar dezinformatat;

► **Dhjetë punëtori për nxënës të shkollave të mesme** mbi përdorimin e ndërjegjshëm të teknologjisë dhe mediave sociale dhe dekonstruktimit e mesazhet komplekse mediatike;

► **Kurs për krijimin e përmbajtjes** i mbajtur për studentët e universitetit në gjuhën serbe në Mitrovicë /Mitrovicë të Veriut, duke u ofruar atyre

mjete dhe aftësi praktike në lidhje me përdorimin e mediave sociale, blogimit, podkasteve, krijim të përmbajtjes dhe komunikimi viziv;

► Mbështetja e **dy kolegjeve private** që ofrojnë programe të medias dhe gazetarisë sipas kurrikulës së EMI-së;

► **Gjashtë shfaqje dokumentare** kanë përdorur storje dhe fakte për të shpjeguar domosdoshmërinë e edukimit medial për të ndërtuar besimin dhe shpjeguar se si teknologjia ndikon në shoqëri.

Përfshirja e Edukimit medial dhe informativ në arsimin formal

► Dezinformatat përçarëse dhe lajmet e rreme përshkojnë mjedisin tonë bashkëkohor të mediave digjitale duke rezultuar në mosbesim, huti dhe përçarje.

► Në vitin 2016, Misioni i OSBE-së në Kosovë e ka ndërmarrë iniciativë për përfshirjen e edukimit medial dhe informativ (EMI) në sistemin e arsimit formal në Kosovë.

► Ky avokim ka dhënë shpejt frytet e tij, pasi shkollat fillore, shkollat e mesme dhe disa universitete e kanë përfshirë EMI-në si lëndë zgjedhore në vitet e fundit.

► Këto arritje ishin të mundshme vetëm falë bashkëpunimit të ngushtë dhe të vazhdueshëm me partnerët lokalë, si shoqëria civile, Ministria e

Arsimit, drejtoritë komunale të arsimit dhe universitetet publike.

► Në prill të vitit 2018, Misioni i OSBE-së ka filluar të punojë me festivalin ndërkombëtar të filmit dokumentar dhe të shkurtër DokuFest për të lehtësuar trajnimet e synuara për mësuesit e shkollave të mesme dhe për të promovuar rëndësinë e EMI-së. Misioni i OSBE-së ka trajnuar rreth 70 mësues të shkollave të mesme mbi konceptet e edukimit medial, duke ndërtuar kapacitetet e tyre për të integruar përdorimin e materialeve të mediave vizive në metodat e tyre të mësimdhënies.

► Kurset e trajnimit i kanë shfrytëzuar kapacitetet ekzistuese të Misionit të OSBE-së dhe DokuFest-it për t'u ofruar mësimdhënësve njohuri, qëndrime dhe aftësi për t'u mundësuar studentëve që të fitojnë shkathtësi për edukimin medial përmes arsimit.




Eroll Bilibani, Shef i Dokulab në DokuFest, së bashku me Misionin e OSBE-së, duke prezantuar në Vjenë **Iniciativën e mbështetur nga OSBE për të përfshirë EMI** në arsimin formal në Kosovë.



Alban Zeneli, profesor në Departamentin e Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës, duke folur me studentët për **rëndësinë e dekonstruktimit të mesazheve komplekse mediatike dhe duke përdorur me ndjeshmëri teknologjinë dhe mediat sociale.**

Pamje nga fushata e Misionit të OSBE-së / Komisionit të Pavarur për Media për angazhimin e publikut për të kontribuar në përmbajtje më të mirë mediale, video me titullin **'Nuk ka vend për nxitje të urrejtjes'**.



Anëtar i Misionit të OSBE-së, Arben Hajredinaj, duke mbajtur **trajnim për edukim medial për mësuesit e shkollave të mesme të organizuar në bashkëpunim me DokuFest.**




Pamje nga një episod i **EduMedia**, një seri e programeve televizive për edukimin mediatik të prodhuara nga Misioni i OSBE-së në Kosovë.



Profesorja Lindita Aliu Tahiri gjatë **ligjëratave mbi edukimin medial dhe informativ** për studentët e universitetit në Mitrovicën e Jugut të organizuara nga Misioni i OSBE-së.

Imazhi vizual që paraqet sloganin e 18-të të edicionit të DokuFest-it, në të cilin Misioni i OSBE-së e ka mbështetur **ndërgjegjësimin për edukimin medial konkursi i titulluar 'e vërtetë ose gënjeshtër: E vërteta në film'**.



Drejtori komunal i arsimit i Komunës së Pejës, Naser Gega, duke iu folur me nxënës të shkollave të mesme gjatë një **punëtorie për edukimin medial dhe informativ** organizuar nga Misioni i OSBE-së.



[www.osce.org/mission-in-kosovo/
media-freedom-and-development](http://www.osce.org/mission-in-kosovo/media-freedom-and-development)

ms-omik@osce.org